



Human Rights Review Panel

Buletini informativ nr. 26 – 30 shtator 2021 – 31 gusht 2022

- Hyrje
- Takimi me shefin e Misionit të EULEX-it Kosovë
- Seancat e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Vendimet e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Publikimi i vendimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut


Hyrje

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (“Paneli”), i themeluar nga Bashkimi Evropian në vitin 2009, është një organ i pavarur llogaridhënës me mandat që të shqyrtojë shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Paneli publikon buletin informativ në mënyrë periodike, në anglisht, shqip dhe serbisht, si pjesë e informimit të qytetarëve të Kosovë, shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar.

Paneli ka pranuar dyqind e tre (203) lëndë prej se ka filluar punën e tij në qershor të vitit 2010. Paneli ka konstatuar që EULEX-i Kosovë ka kryer shkelje të të drejtave në pesëdhjetë e dy (52) lëndë. Përpos kësaj, Paneli ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në gjashtëmbëdhjetë (16) lëndë të tjera, të cilat i ka konsideruar të pranueshme. Për momentin në Panel janë njëzet e tre (23) lëndë të hapura, nga të cilat njëzet e një (21) lëndë janë lëndë përcjellëse të konstatimeve të mëparshme të ndonjë shkeljeje. Paneli gjithashtu ka lëshuar tridhjetë e dy (32) vendime përcjellëse në njëzet e pesë (25) lëndë, ku ka vlerësuar shkallën në të cilën Misioni kishte zbatuar rekomandimet e tij. Në shumë raste, Paneli ka konstatuar se zbatimi ishte vetëm i pjesshme. Në disa raste është dashur të lëshoheshin vendime pasuese të njëpasnjëshme.

Lëndët në Panel kanë të bëjnë me një sërë faktorësh thelbësor dhe procedural të të drejtave të njeriut, në thelb përfshirë të drejtat e jetës, respektimin e jetës private dhe familjare dhe të drejtën për mjet efektiv juridik. Pjesa e plotë e praktikës gjyqësore gjendet në: <https://hrrp.eu/alb/cases.php>.

Statistikat e lëndëve - gusht 2022



Vini re se në disa lëndë janë të përfshira ankesa të shumta dhe jo të gjitha ishin (të pa)pranueshme.

Takimi me shefin e Misionit të EULEX-it Kosovë

Më 5 korrik 2022, Paneli u takua me z. Lars-Gunnar Wigemark, shef i Misionit të EULEX-it Kosovë. Diskutimi u përqendrua rreth rekrutimit të anëtarëve të rinj të Panelit dhe zbatimit të rekomandimeve të Panelit në njëzet (20) rastet e personave të zhdukur.

Seancat e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Në periudhën janar-gusht 2022, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur dy seanca. Seancat e Panelit janë mbajtur në Prishtinë, me përjashtim të ditës së fundit shtesë të seancës së dytë, gjatë së cilës Paneli ka diskutuar përmes mjeteve elektronike në përputhje me rregullën 13(3) të rregullores së punës së Panelit.

- Seanca e 53-të: 22-25 mars 2022.
- Seanca e 54-të: 5-7 korrik dhe 18 gusht 2022.

Vendimet e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Në seancën e 54-të, Paneli shpalli një lëndë të papranueshme dhe një lëndë të pranueshme. Në këtë rast të pranueshëm, Paneli gjithashtu vlerësoi meritat e ankesave dhe gjeti se EULEX-i Kosovë kishte shkelur obligimet e veta ndaj të drejtave të njeriut në lidhje me ankuesin. Paneli gjithashtu ka formuluar rekomandime për shefin e Misionit.

Në një rast kur Paneli kishte gjetur më parë shkelje, Paneli nxori një vendim pasues të pestë me radhë për të shqyrtuar dhe vlerësuar zbatimin e rekomandimeve nga shefi i Misionit të EULEX-it.

Në një rast tjetër ku Paneli më parë kishte gjetur shkelje, Paneli nxori një vendim pasues për të shqyrtuar dhe vlerësuar zbatimin e rekomandimeve nga shefi i Misionit të EULEX-it. Paneli vendosi të mbyllë shqyrtimin e këtij rasti.

Po ashtu, në një rast të ri, kryesuesja e Panelit i ka dorëzuar shefit të Misionit një kërkesë për zbatimin e masave të përkohshme.

Vendim në lidhje me kërkesën për zbatimin e masave të përkohshme

- Lënda 2021-02 O.L. dhe të tjerët kundër EULEX-it. Më 24 gusht 2022, kryesuesja e Panelit nxori një vendim mbi kërkesën për zbatimin e masës së përkohshme, mbi bazën e autoritetit të saj sipas Rregullës 22 Masat e Përkohshme të Rregullores së Punës së Panelit. Shefit të Misionit iu kërkua të ndërmarrë çfarëdo veprimi të nevojshëm, në përpjesëtim me rrezikun për jetën e ankuesit ose familjes së tij, dhe brenda mandatit të tij, për të garantuar sigurinë e ankuesve. Kryesuesi ftoi shefin e Misionit që t'i raportojë Panelit për veprimet e ndërmarra.

Vendimet e papranueshmërisë

- Lënda [2019-02 Driton Hajdari dhe Teuta Bici-Hajdari kundër EULEX-it](#). Më 7 korrik 2022, Paneli e shpalli këtë rast të papranueshëm. Ankesa lidhej me kushtet e paraburgimit të ankuesit të parë dhe ndikimin që rezultoi tek ankuesi i dytë. Paneli e shpalli këtë ankesë të papranueshme për shkak se ngjarjet për të cilat është bërë ankesa nuk i janë ngarkuar EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv dhe për këtë arsye nuk kanë hyrë në fushëveprimin e juridiksionit të Panelit.

Vendimet e pranueshmërisë

- Lënda [2016-29 Slađana Savić kundër EULEX-it](#). (Shih më poshtë në vendimet mbi meritat).

Vendimet për meritat

- Lënda [2016-29 Slađana Savić kundër EULEX-it](#). Më 18 gusht 2022, Paneli miratoi Vendimin mbi Pranueshmërinë dhe Meritat. Në vendimin e tij, Paneli përcaktoi se EULEX-i nuk e kishte kryer një hetimi efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankueses dhe nuk e kishte mbajtur të informuar ankuesen. Si rezultat, Paneli përcaktoi se Misioni ishte përgjegjës për një shkelje sipas pjesës procedurale të së drejtës së ankueses për jetë, siç garantohet me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për shkelje të së drejtës së ankueses për mos t'ju nënshtruar trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë të pyesë autoritetet se çfarë hapash janë duke u ndërmarrë për të hetuar këtë rast dhe për t'iu theksuar autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe për t'u informuar për rrjedhën e përgjithshme të hetimit. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit që të kontaktojë ankuesen me qëllim të gjetjes së një mjeti juridik për shkeljen e të drejtave të saj. Zbatimi i këtyre rekomandimeve nga Misioni është në pritje.

Vendimet përcjellëse

- Lënda [2011-20 X. dhe 115 të tjerë kundër EULEX-it](#). Me vendimin e datës 22 prill 2015, Paneli përcaktoi se EULEX-i ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ankuesve për një mjet efektiv, siç garantohet me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit. Më 11 nëntor 2015, më 10 janar 2017, më 27 mars 2019 dhe përsëri më 11 dhjetor 2019, Paneli nxori vendime pasuese rreth zbatimit të rekomandimeve.

Më 18 gusht 2022, Paneli miratoi Vendimin e Pestë për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Në këtë endim, Paneli theksoi se ankuesve ende duhet t'u sigurohet një mjet dhe kompensim adekuat për shkeljen e të drejtave të tyre. Paneli përsëriti ftesën e tij drejtuar EULEX-it që të kryejë një rishikim të plotë të mjeteve në dispozicion të Misionit për të korrigjuar shkeljen e të drejtave të ankuesve në mënyrë efektive dhe për t'i raportuar Panelit për masat që ai propozon t'i zbatojë për ta bërë këtë. Paneli gjithashtu ftoi Misionin që të merr parasysht t'i kontaktoj shtetet anëtare përmes Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm në lidhje me mundësinë e dëmshpërblimit ose kompensimit për shkeljen e të drejtave të ankuesve që i ngarkohet Misionit nga Paneli.

- Lënda [2018-01 Y.B.2 kundër EULEX-it](#). Me vendimin e datës 16 shtator 2021, Paneli përcaktoi se EULEX-i ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ankuesit për respektimin e jetës së tij private, siç mbrohen me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më 6 korrik 2022, Paneli miratoi Vendimin për Zbatimin e Rekomandimeve të Panelit. Në atë vendim, Paneli theksoi se shefi i Misionit të EULEX-it kishte refuzuar të lëshonte një deklaratë publike duke pranuar shkeljen e të drejtave të ankuesit. Paneli shprehu keqardhje për moszbatimin e këtij rekomandimi të Panelit, por vendosi se nuk do të ishte e dobishme të përsëritej rekomandimi i tij. Paneli vendosi të mbyllë shqyrtimin e këtij rasti.

Publikimi i vendimeve

Të gjitha vendimet e Panelit janë të publikuara në faqen e internetit të Panelit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe dhe mund të gjenden në: www.hrrp.eu.

Vizitoni faqen tonë të internetit: www.hrrp.eu.



SI TË PARASHTROHET ANKESA NË PShDNj
(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person që nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij. Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga Misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij. Paneli nuk i shqyrton procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur? Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si? Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular. Nëse ankesa paraqitet në letër, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tutje.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:



Human Rights Review Panel - Sekretariat
Rrustem Statovci Street no. 29 – 10000 Pristina – Kosovo
Tel: +383 (0) 38 28 2207
A complaint can also be sent by email to office@hrrp.eu
www.hrrp.eu

Nëse ankesa parashtrohet përmes postës elektronike, atëherë ankesa origjinale e nënshkruar duhet të dorëzohet brenda katër javëve nga data e dërgimit të postës elektronike.

Plotësimi i formularit për ankesë Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtër (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.). Gjatë regjistrimit ankesës i caktohet numri i dosjes.

Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.